



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 297 /2010**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga Rafet Haxhaj, kryesues, Nehat Idrizi dhe Vlastimir Dimic, anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Suzana Novobërdaliu, Përfaqësuese e Subjektit Politik Aleanca Kosova e Re (AKR), që ka të bëjë me shkeljen e Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2009 “Kodi të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët”, në seancën e mbajtur me datë 02.12.2010 mori këtë:

**VENDIM**

**HIDHET** poshtë ankesa si e palejuar.

**ARSYETIMI**

Suzana Novobërdaliu, përfaqësuese ligjore e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) në Prishtinë, ka parashtruar ankesë me të cilën pretendon se Partia Demokratike e Kosovës-PDK ka bërë shkeljen e Ligjit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës-LZP dhe Rregullën Zgjedhore “Kodi të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët”, të cilët para fushatës zgjedhore kanë vendosur reklamat e subjektit të tyre politik, garues për zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë.

Subjekti Politik PDK, ka vendos reklamat në vendet e ndryshme të kryeqytetit, si në rrugën “Gazmend Zajmi”, “Fehmi Lladrovci” dhe “Xheladin Rekalii”

**FAKTET**

Më 30 Nëntor 2010, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ka pranuar ankesën me nr. A-297, nga Suzana Novobërdaliu, përfaqësuese ligjore e subjektit politik (AKR) në Prishtinë, duke pretenduar se PDK ka bërë shkeljen e Ligjit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës-LZP dhe Rregullën Zgjedhore “Kodi të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët”, duke vendosur reklamat e subjektit të tyre politik para fushatës zgjedhore.

Parashtruesja e ankesës ka bashkangjitur fotokopjet e fotografive që duken të jenë reklamat e subjektit politik PDK nëpër rrugët e kryeqytetit.

Parashtruesja e ankesës kërkon nga PZAP-i që urgjentisht të shqyrtojë këtë ankesë dhe të marr të gjitha masat e duhura ligjore në bazë të dispozitave ligjore të aplikueshme.

## ANALIZË

Jurisdiksioni i PZAP'it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me autorizimin e dhënë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës në Ligjin Nr. 03/L-256, dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 03/L-072).

LZP me dispozitën e nenit 44, përcaktohen aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore në mënyrat e specifikuar me atë dispozitë ligjore.


LZP me dispozitën e nenit 33 dhe Rregullorja e Zgjedhjeve Nr 11/2009, *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*, me dispozitën e nenit 4, u ndalojnë veprimet e subjekteve politike, mbështetësve të tyre ose kandidatëve të tyre, të caktuara me këto dispozita ligjore gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Meqenëse veprimet e pretenduara nuk janë bërë gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, vlerësohet në pajtim me dispozitat e cituara ligjore se nuk kemi të bëjmë me veprime të ndaluara, për çka edhe vlerësohet se ankesa është si e palejuar.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

A nr. 297/2010 më datën 02.12.2010.

Kryesuesi i Panelit  
Rafet Haxhaj



*[Handwritten signature]*